



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1921/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI176/21

Parashtrues

Xhemajl Dervishi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP. nr. 80/2020, të 17
dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Xhemajl Dervishi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [ARJ.UZVP. nr. 80/2020] i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 17 dhjetorit 2020.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 17 qershor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta e tij e mbrojtur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 30 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 8 tetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj, si dhe njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 11 tetor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të kërkesës.
10. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e rastit rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) në pozitën *“Drejtor i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë”*.

Përmbledhja e fakteve në procedurë administrative

12. Më 8 shkurt 2017, punëdhënësi kishte pranuar shkresë nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, përmes së cilës këta të fundit shprehën shqetësim lidhur me veprimet e parashtruesit të kërkesës rreth implementimit të dy projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian lidhur me ndërtimin e kapaciteteve që kanë të bëjnë me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Përmes kësaj shkrese, udhëheqësit e projekteve specifike në kuadër të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, kishin identifikuar probleme serioze në implementimin e projekteve, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit të parashtruesit të kërkesës si dhe stafit teknik, me urdhër të parashtruesit të kërkesës.
13. Më 10 shkurt 2017, kryeshefi ekzekutiv i punëdhënësit, kishte iniciuar procedurën disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se kishte bërë shkelje disiplinore duke u bazuar në shkresën e dërguar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, përmes së cilës këta të fundit shprehën shqetësim lidhur me veprimet e parashtruesit të kërkesës rreth implementimit të dy projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian.
14. Më 9 mars 2017, Komisioni Disiplinor i punëdhënësit, pas shqyrtimit të provave në mbështetje të nenit 66, paragrafi 4, nënparagrafi 4.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 8, paragrafi 1.3 të Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore, përmes Vendimit [AUV/01-050/2017] kishte shqiptuar masën disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës si në vijim: *“Largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet”*, duke konsideruar se ky i fundit kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1, nënparagrafët 1.10, 1.15, 1.16 dhe 1.17 të Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore. Më tutje, në Vendimin e lartcekur theksohet se: *“në këtë rast me veprimet apo mosveprimet e tij ka bërë shkeljen të rënda –serioze të detyrave të punës [...]”*. Nga Vendimi i lartcekur rezulton se edhe përkundë se parashtruesi i kërkesës, ishte ftuar në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë në seancën e Komisionit Disiplinor, ky i fundit nuk i ishte përgjigjur ftesës.
15. Më 13 mars 2017, punëdhënësi, përmes Vendimit [AUV/01-054/2017] bazuar në Vendimin e lartcekur të Komisionit Disiplinor, kishte caktuar parashtruesin e kërkesës në pozitën Koordinator i Zyrës Regjionale në Prishtinë nga pozita Drejtor i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë.
16. Më 22 mars 2017, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në shkallën e dytë pranë punëdhënësit, kundër Vendimit të lartpërmendur të Komisionit Disiplinor të punëdhënësit, duke mos specifikuar arsyet se pse e kundërshton vendimin e lartcekur.

17. Më 11 prill 2017, përmes Vendimit [Nr.2352] instanca e dytë e punëdhënësit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin [nr. AUV/01-050/2017] të 9 marsit 2017 të Komisionit Disiplinor të punëdhënësit, duke e konsideruar këtë të fundit si të drejtë dhe të ligjshëm. Nga Vendimi vërehet se edhe përkundër se parashtruesi i kërkesës ishte ftuar në mënyrë të rregullt për të marrë pjesë në seancën e Komisionit Disiplinor, ky i fundit nuk i ishte përgjigjur ftesës.
18. Më 8 maj 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Vendimit të punëdhënësit [nr. AUV/01-050/2017] pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK).
19. Përmes Vendimit [A/02/220/2017] të 20 qershorit 2017, KPMSHCK shfuqizoi Vendimin e instancës së dytë të punëdhënësit, të 11 prillit 2017, Vendimin [AUV/01-050/2017] e 9 marsit 2017 si dhe Vendimin [AUV/01-054/2017] e 13 marsit 2017, duke theksuar se instanca e dytë e punëdhënësit me rastin e nxjerrjes së Vendimit [Nr.2352], kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Ligjin Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave si dhe gjendja faktike nuk ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë. Përmes Vendimit të lartcekur KPMSHCK-ja obligoi Komisionin Disiplinor të punëdhënësit që të bëjë rishqyrtimin e rastit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke nxjerrë vendim në të cilin specifikohet saktë koha e ndalimit të gradimit.
20. Më 6 korrik 2017, punëdhënësi, përmes Vendimit [AUV/01-192/2017] kishte caktuar D.Z., koordinator të Zyrës regjionale në Prizren, që ta zëvendësojë kryetarin e Komisionit Disiplinor për seancën disiplinore lidhur me procedurën e rishqyrtimit të Vendimit [AUV/01-050/2017] të 9 marsit 2017, duke u bazuar në vendimin e KPMSHCK-së [A/02/220/2017] të 20 qershorit 2017. Zëvendësimi ishte bërë me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.
21. Më 13 korrik 2017, duke u mbështetur në Vendimin e KPMSHCK-së [A/02/220/2017], Komisioni Disiplinor i punëdhënësit, përmes Vendimit [AUV/201/2017], i shqiptoi parashtruesit të kërkesës masën disiplinore *“Largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit katër (4) vjet”*.
22. Më 14 korrik 2017, punëdhënësi, përmes Vendimit [Ref.AUV/01-203/2017], caktoi parashtruesin e kërkesës në pozitën koordinator i Zyrës regjionale në Prishtinë.
23. Më 3 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në shkallën e dytë pranë punëdhënësit, kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të punëdhënësit [AUV/201/2017] të 13 korrikut 2017.
24. Më 23 gusht 2017, instanca e dytë e Komisionit Disiplinor, përmes Vendimit [Nr.9303], e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vendosur që Vendimi [AUV/201/2017] i Komisionit Disiplinor të punëdhënësit, i 13 korrikut 2017, të mbetet në fuqi.

25. Më 18 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë para KPMSHCK-së, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të punëdhënësit të 23 gushtit 2017, duke pretenduar shkelje të dispozitave ligjore dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike.
26. Më 27 tetor 2017, KPMSHCK, përmes Vendimit [A/02/541/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke lënë në fuqi Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të punëdhënësit të 23 gushtit 2017 si dhe Vendimin [AUV/201/2017] të 13 korrikut 2017 të Komisionit Disiplinor të punëdhënësit. Kolegji shqyrtues i KPMSHCK-së kishte vlerësuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i punëdhënësit kishte vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, meqenëse parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe se masa disiplinore e shqiptuar ndaj tij ishte në proporcion me shkeljen që kishte kryer.

Përmbledhja e fakteve në procedurën para gjykatave të rregullta

27. Më 21 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me propozimin që të anulohet Vendimi [A/02/541/2017] i KPMSHCK-së, duke kërkuar që në mungesë provash të lirohet nga përgjegjësia disiplinore për shkelje të nenit 6 paragrafi 1, nënparagrafët 1.10, 1.15, 1.16 dhe 1.17 të Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore.
28. Më 5 shtator 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [A. nr. 1970/2017] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e Vendimit [A/02/541/2017] të 27 tetorit 2017 të KPMSHCK-së. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë theksohet se Vendimi i KPMSHCK-së ishte mjaftueshëm i arsyetuar dhe bazuar në faktet, provat dhe shkresat e lëndës.
29. Gjykata Themelore në Prishtinë vlerësoi se parashtruesi i kërkesës me veprimet dhe mosveprimet e tij kishte bërë shkelje të detyrave të punës, të sanksionuara me nenin 66, paragrafi 1 dhe nenin 52, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, vërtetuar me shkresën e Zyrës së BE-së në Kosovë nr.526 e 08.02.2017 dhe nga shkëmbimet elektronike të 10.02.2017; 13.02.2017; 15.02.2017; 12.02.2017; 17.02.2017; 17.01.2017; 05.01.2017, kërkesën për qasje në dokumente zyrtare të 27.04.2017; 03.05.2017; 08.02.2017; 17.07.2017 dhe shkresave të tjera. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore në Prishtinë vlerësoi se masa disiplinore e shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës ishte në përputhje me lëshimet e bëra nga ana e tij dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
30. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për degradim në pozitë, Gjykata Themelore nuk e pranoi atë si të bazuar ndërsa pretendimin për kompensim të humbur për tri (3) vite e refuzoi, duke konstatuar se masa disiplinore ishte shqiptuar në përputhje me shkeljen e kryer si dhe dispozitat e ligjit dhe rregullores së lartcekur.

31. Më 23 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [A. nr. 1970/2017] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe shkelje të dispozitave materiale.
32. Më 21 shtator 2019, Gjykata Apelit, përmes Aktgjykimit [AA. nr. 822/2019], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit në arsyetim të vendimit të saj shtoi se Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Themelore në Prishtinë ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe nuk ishte përcjellë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit ndër të tjera theksoi se *“...kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë , ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit”*.
33. Më 3 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
34. Më 17 dhjetor 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ.UZVP. nr. 80/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Supreme në arsyetim të Aktgjykimit të saj konstatoi se Gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e tij e mbrojtur me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
36. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore kundër tij, pranë punëdhënësit ashtu edhe gjatë zhvillimit të procedurave pranë gjykatave të rregullta, ka pasur aplikim diskriminues të ligjit dhe mungesë të dëshmive konkrete për shkelje të rëndë të detyrave të punës.
37. Parashtruesi i kërkesës në vijim thekson se: *“Asnjë provë nuk verteton se unë si shërbyes civil i Kosovës kam shkelur ndonjë detyrë dhe që ndërlidhet me punës. Kësisoj ne mënyrë diskriminuese ishte aplikuar neni 66, paragrafi 1 i Ligjit 03/L-149 dhe neni 52 i Ligjit 03/L-149. Kësisoj konsideroj se në rastin konkret më është shkel e drejta për gjykim të drejtë e te paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës sepse masat disiplinore më është shqiptuar vetëm mbi bazën e një konstatim subjektiv të një zyrtari të Komisionit Evropian, pa u vërtetuar se cilat ishin veprimet e mia konkrete që edhe vërtetojnë konstatimin se unë kisha penguar implementimin e projekteve për mbeshtetjen e Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV-së”*.

38. Tutje, parashtuesi i kërkesës shton se: “Çdo aplikim diskriminues i ligjit apo vertetim i vendimeve që nuk janë kompatible me faktet e vërtetuara përbën shkelje të drejtës në gjykim të drejtë e të paanshëm”.
39. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesën ta deklarojë si të pranueshme, të anulojë vendimin e kontestuar dhe të urdhërojë vendosjen e serishme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkojë nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI NR. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 52

Detyrimi për mos shpërdorimin e autoritetit

1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, nëpunësit civilë duhet të përkushtohen në zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e interesit publik dhe jo në realizimin e fitimeve personale apo për individë apo organizata të tjera.
2. Nëpunësit civilë nuk do të bëjnë veprime apo të marrin vendime, të cilat i tejkalojnë kufijtë e rangut dhe funksioneve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me këtë ligj.
[...]

4. Nëpunësit civilë nuk do të shfrytëzojnë, për çfarëdo qëllimi, pozitën e tyre si përfaqësues të autoritetit publik për të detyruar apo për të kërkuar nga palët e treta ose kolegët dhe personeli të cilin e mbikëqyrin që të kryejnë punë, të bëjnë lëshime ose të marrin masa të jashtëligjshme ose që përbejnë veprë penale.

Neni 64 Përgjegjësia disiplinore

1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji.
2. Nëpunësit civilë, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e personelit, janë përgjegjës për menaxhim dhe mbikëqyrje të mirë. Neglizhenca ose dështimi në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes konsiderohet shkelje e detyrës dhe iu nënshtrohet masave disiplinore.
3. Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore.

Neni 65 Përgjegjësia për dëmet

1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara qytetarëve ose institucionit gjatë ushtrimit të detyrës si rezultat i paaftësisë profesionale, neglizhencës së rëndë ose veprimeve të qëllimshme, të paligjshme.
2. Pas përcaktimit të përgjegjësisë, do të bëhet sanksionimi i nëpunësit civil, i cili i ka shkaktuar dëm institucionit ose qytetarëve.

Neni 66 Kushtet e zbatimit të masave disiplinore

1. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor.
2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze, të cilat do të rregullohen me akt nënligjor.
[...]
4. Për shkelje të rënda – serioze shqiptohen masat disiplinore si në vijim :
4.1. pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 4.2. largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni

disiplinor; 4.3. ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor.

LIGJI Nr. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 16

1. Akti administrativ përfundimtar mund të kundërshtohet:

1.1. për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore;

1.2. për shkak se akti është nxjerrë nga organi jo kompetent;

1.3. për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike;

[...]

Neni 44

1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë.

2. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

RREGULLORE NR. 04/2011 PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË SHËRBIMIN CIVIL

Neni 6

Shkeljet e rënda-serioze

1. Shkelje të rënda-serioze, konsiderohen:

[...]

1.10. Shkelja e detyrave të punës, që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror;

[...]

1.15. kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprimet që e dëmtojnë institucionin dhe organet tjera shtetërore;

1.16. Sjellja apo kërcënim i që u pamundëson, i pengon apo ua vështirëson të tjerëve kryerjen me sukses të detyrave zyrtare të punës;

1.17. mosofrimi i ndihmës profesionale në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës nëpunësve civilë, funksionarëve publikë, dhe palëve gjatë realizimit të të drejtave të tyre ligjore;

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

40. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

42. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

43. Rreth përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.UZVP. nr. 80/2020] të 17 dhjetorit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

44. Gjykata vëren, se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
45. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
46. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
47. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*.
48. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune tek punëdhënësi në pozitën *“Drejtor i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë”*. Pas ankesës së parashtruar nga Zyra e BE-së në Kosovë, për shkaktim të problemeve serioze në implementim të projekteve dhe për mungesë të bashkëpunimit, ndaj parashtruesit të kërkesës ishte iniciuar procedurë disiplinore pranë punëdhënësit. Më 9 mars 2017, Komisioni Disiplinor i punëdhënësit, përmes Vendimit [AUV/01-050/2017] i shqiptoi parashtruesit të kërkesës masën disiplinore *“Largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i*

gradimit deri në pesë (5) vjet”, duke konsideruar se ky i fundit kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës. Pas marrjes së këtij vendimi, punëdhënësi kishte caktuar parashtruesin e kërkesës në pozitën koordinator i Zyrës regjionale në Prishtinë nga pozita drejtor i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë. Vendimi i lartcekur i Komisionit Disiplinor i 9 marsit 2017 ishte vërtetuar nga instanca e dytë pranë punëdhënësit. Pas parashtrimi të ankesës kundër punëdhënësit para KPMSHCK-së, ky i fundit, përmes Vendimit [A/02/220/2017] të 20 qershorit 2017, shfuqizoi vendimet e punëdhënësit, duke e obliguar Komisionin Disiplinor që të bëjë rishqyrtimin e rastit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke nxjerrë vendim në të cilin ceket saktë koha e ndalimit të gradimit. Kësisoj, më 13 korrik 2017, duke u mbështetur në Vendimin e KPMSHCK-së [A/02/220/2017], Komisioni Disiplinor i punëdhënësit, përmes Vendimit [AUV/201/2017], i shqiptoi parashtruesit të kërkesës masën disiplinore *“Largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit katër (4) vjet”*. Ky vendim u vërtetua nga instanca e dytë pranë punëdhënësit dhe pastaj edhe nga KPMSHCK, ku ky i fundit e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke vlerësuar se gjendja faktike dhe juridike ishte vërtetuar drejtë.

50. Më 21 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me propozimin që të anulohet Vendimi [A/02/541/2017] i KPMSHCK-së. Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [A.nr.1970/2017] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se Vendimi i KPMSHCK-së ishte mjaftueshëm i arsyetuar dhe se masa disiplinore shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës ishte në përputhje me lëshimet e bëra nga ana e tij. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë u vërtetua në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AA.nr.822/2019] të 21 shtatorit 2019, duke u vlerësuar si vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Ndërkaq, më 17 dhjetor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.UZVP. nr. 80/2020], e refuzoi kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi se vendimi i shkallës së dytë ishte nxjerrë në përputhje me të drejtën materiale.
51. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës konteston konstatimin e Gjykatës Supreme, duke pretenduar se me Aktgjykimin e kontestuar, nuk është shqyrtuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmëria e vendimit të nxjerrë në procedurë administrative. Sipas parashtruesit të kërkesës, përmes aplikimit në mënyrë diskriminuese të ligjit, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(i) *Lidhur me pretendimin për zbatim në mënyrë të gabuar të ligjit*

52. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit të tij për aplikim në mënyrë diskriminuese të nenit 66, paragrafi 1 dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, konsideron se ka pasur mungesë provash që dëshmojnë shkeljen e detyrave të punës. Parashtruesi i kërkesës thekson se masa disiplinore kundër tij ishte shqiptuar vetëm mbi bazën e konstatimit subjektiv të një zyrtari të Komisionit Evropian, pa u vërtetuar veprimet konkrete në pengimin e implementimit të aktiviteteve të projekteve, që përbëjnë shkelje të detyrave të punës. Parashtruesi i kërkesës, në vijim pretendon se gjykata vendimmarrëse nuk ka shqyrtuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmërinë e vendimit të nxjerrë

- në procedurë administrative. Sipas parashtguesit të kërkesës, gjatë procedurës disiplinore nuk ishin ofruar prova konkrete që dëshmonin shkeljen e detyrave të punës.
53. Gjykata rikujton se parashtguesi i kërkesës pretendon se përveç letrës së Zyrës së BE-së në Kosovë nuk ishte ofruar asnjë provë konkrete gjatë procedurës disiplinore që dëshmon kryerjen e shkeljes së rëndë të detyrave të punës
 54. Nga pretendimet e paraqitura, Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës, në thelb, pretendon interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës Supreme.
 55. Prandaj, bazuar në shtjellimet e pretendimeve të parashtguesit të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
 56. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KI87/20, parashtgues Suva Rechtsabteilung, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 57; KIO6/17, parashtgues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtgues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55 dhe KI122/16, parashtgues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
 57. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin *Ballıktaş Bingöllü kundër Turqisë*, GJEDNJ, nr. 76730/12 i 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtgues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KIO6/17, parashtgues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtgues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
 58. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë*, kërkesa nr. 65167/01, Vendimi për pranueshmëri i 30 qershorit 2005; dhe rastet e Gjykatës të cituara më lart KIO6/17, parashtgues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtgues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).

59. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Päduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
60. Në rastin konkret, Gjykata ka parasysh se Gjykata Supreme kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm e kishte parashtruar kundër Aktgjykimit [AA.nr.822/2019] të 21 shtatorit 2020, të Gjykatës së Apelit. Gjykata rikujton se në kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, parashtruesi i kërkesës kontestoi ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
61. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ARJ.UZVP.nr.80/2020 të 17 dhjetorit 2020, kishte vlerësuar se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Në arsyetimin e Gjykatës Supreme theksohet se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar në mënyrë të drejtë se vendimi i kontestuar është i drejtë, se organi administrativ ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike si dhe në mënyrë të drejtë ka aplikuar të drejtën materiale.
62. Sa i përket pretendimit të lartpërmendur, Gjykata rikujton konstatimin e bërë nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj se: *“...gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë konstatuar se e paditura-Agjencia e Ushqimeve dhe Veterinari e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike se paditësi ka kryer shkelje të rënda disiplinore. Nga shkresat e Zyrës së BE nr.526 dt.08.02.2007, me të cilat është e njoftuar Agjencia për Ushqime dhe Veterinari, në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se kanë ekzistuar ankesa të shumta nga personat e interesuar dhe në veçanti nga ana e udhëheqësve të caktuar të angazhuar për implementimin e dy projekteve të financuara nga BE, gjë që është mundur të vërtetohet edhe nga shkresat elektronike të 05.01.2017; 10.02.2017; 13.02.2017; 15.02.2017; 17.02.2017; si dhe nga kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të 27.04.2017; 03.05.2017; 08.02.2017 dhe të 17.07. 2017...”*.
63. Gjykata gjithashtu rikujton se shkresat e lartcekura elektronike i ishin paraqitur edhe Komisionit Disiplinor si dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të punëdhënësit, pasqyruar në vendimet përkatëse të 9 marsit 2017; 11 prillit 2017; 13 korrikut 2017 dhe 23 gushtit 2017.

64. Gjykata ripërsëritë se Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës të cituar më lart, KI75/17, parashtrues X, paragrafi 59).
65. Megjithatë, bazuar në shtjellimet e mësipërme, si dhe interpretimin dhe arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme, në rastin konkret, nuk është dëshmuar që ka arbitraritet në interpretimin e dhënë nga Gjykata Supreme me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.
66. Prandaj, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i aplikimit në mënyrë diskriminuese të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i “*ligjshmërisë*” nga Gjykata Supreme, mund të ketë qenë jo i drejtë.
67. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka arritur të dëshmojë dhe të mbështesë pretendimin e tij se si Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

